

## KONTRATE MBI ANKANDIN PUBLIK

Shitja e masës drusore të pa prera (në këmbë) në njësin e Zhegocit – Zhegoc

(Kishnapole)

ngastra nr.56(03) / Lot II

me numër identifikues: Gi 651 -18-003

neni 1. Lënda

Kjo kontratë e lidhur me datën 14/08/2018 në mes të: Komunës së Gjilanit këtu e tutje i referuar me "Autoriteti Kontraktues", në njëren anë,

dhe SH.P.K. " PYLLA Rr.Qarkore Nato 99 nga Gjilani (këtu e tutje i referuar si "Blerësi"), në anën tjetër:

NDËRSA Autoriteti Kontraktues ka ftuar ofertuesit për Shitja e masës drusore të pa prera (në këmbë) në njësin e Zhegocit – Zhegoc (Kishnapole), ngastra nr.56 (03) lot II

dhe ka pranuar tenderin me çmimin më të lartë të dorëzuar nga blerësi për blerjen e kësaj mase drusore.

TANI KJO MARRËVESHJE DËSHMON SI NË VIJIM:

1. Blerësi pajtohet të paguaj në dy këste për masën drusore (dru të pa prera) edhe atë kësti i par i cili është edhe avans 40 % të vlerës së kontratës (ku ky këst merret edhe si sigurim i kontratës), kurse kësti i dytë do të paguhet në shumën mbetur të pagesës e cila do të bihet pas palimit dhe matjes së druve të cilin do ta bëjë një komision i veçantë nga Drejtorati i Bujqësisë.

- 1.1.1 Kontraktori nuk do të filloj me têrheqjen e masës drusore e cila ka qen objekt i ankandit publik pa e bërë pagesën në têrësi sipas çmimit të fundit të dhënë në ankand nga ana e vetë blerësit.
2. Duke konsideruar pagesat e kryera nga Blerësi, Autoriteti Kontraktues, siç theksohet në Konratë, pajtohet të lejoj bartjen e masës drusore në pajtim me dispozitat e kontratës.
3. Kontraktori do të filloj me têrheqjen e masës drusore mbrenda (5 ditë) pasë nenshkrimit te kontrates, dhe menjëherë pas pagesës së tyre, afati për têrheqjen e masës drusore është 120 ditë pune nga dita e fillimit të têrheqjes (plani dinamik i têrheqjes).
4. Nëse kontraktori gjendet duke vepruar në pyll në kundërshtim me ligjin, duke prerë dhe transportuar masë drusore jashtë sasisë së paraparë me këtë konratë apo duke transportuar pa lejen e Autoritetit Pyjor automatikisht I ndërpritet kontrata dhe ndaj tij do të inicohet procedure gjyqësore si dhe do ti ndalohet aplikimi I mëtutjeshëm nëpër Ankande publike dhe tenderë.

## Neni 2 Lokacioni i masës drusore

2.1 Lokacioni i masës drusore ( dru në këmbë) është *në ngastren nr. 59(03) Zhegoc- Kishno Pole*

2.2 Zyrtari që duhet kontaktuar për aranzhimin e marrjes së masës drusore ( dru në këmbë) është Autoriteti Pyjor Komunal - i cili do ta caktoj një komision që do ta vëzhgoj kontraktorin gjatë têrheqjes së masës drusore dhe në fund do ta përpiloj një procesverbal mbi sasinë e masës drusore ku do të nënskruaj si komisioni ashtu edhe kontraktori.

2.3 Sasia bruto (m<sup>3</sup>) 801.06( vëëlimi ) dhe lloji i druve:

## Neni 3 Çmimi i kontratës

4.1 Çmimi total do të jetë: **27,316.14 €;**

*shëno çmimin me fjalë: Njëzet e shtatëmijë e treqind e qashtëmbëdhjetë Euro e Katërbëdhjetë centi*

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 është një sasi e cila mund të ndryshoj për shkak të specifikave të druve pasi që drutë janë shitur të pa prera e kontraktori pas prerjes dhe palimit të tyre do të dihet saktë sasia e masës drusore ku çmimi për njësi do të dominoj.

3.3 Çmimi për njësi do të jetë përfundimtar dhe nuk do të ndryshohet.

#### Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (c) Përshkrimi i Aseteve; masë drusore (dru në këmbë)
- (d) Ankandi i mbajtur me datën 18.06.2018.





4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Blerësit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhet me shkrim. Komunikimet do të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri originale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Blerësin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Blerësin	
Emri:	Izet Kurteshi	Emri:	Asllan Shkodra
Pozita:	Ud. Menaxher i Zyrës së Prokurimit	Pozita:	Drejtës
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.08.2018	Data:	14.08.2018
Vula:		Vula:	
Për Autoritetin Kontraktues		Për Blerësin	
Emri:	Shqipe Hoxha	Emri:	Asllan Shkodra
Pozita:	E autorizuar Zyrës së Prokurimit	Pozita:	Drejtës
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.08.2018	Data:	14.08.2018
Vula:		Vula:	